

VENDIM
Nr. 300, datë 23.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 23, DATË 12.1.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET
AUTORITETEVE TË STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR
TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT
TË PARAZGJERIMIT (IPA), KOMPONENTI I: ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE
FORCIMI INSTITUCIONAL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për Rregullat e Bashkëpunimit për Asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, ratifikuar me ligjin nr. 9840, datë 10.12.2007, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr. 23, datë 12.1.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimet “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU), në Ministrinë e Financave”, “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, në Ministrinë e Financave” dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve” zëvendësohen me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, në varësi të ministrit përgjegjës për financat.””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama